



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 04.12.2012, miratoi këtë

**V E N D I M**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR DHËNIEN E BANESAVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS NË SHFRYTËZIM ME QIRA PËR RASTET ME PËRKUJDESJE SOCIALE 01. NR. 360 - 1938, TË DT. 28.7.2010**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënie e banesave në shfrytëzim me qira për rastet me përkujdesje sociale, 01. nr. 360 -1938, të dt. 28.7.2010.

**II.**

Në nenin 4, paragrafi 4.1, pas fjalëve deri në 10 vjet , shtohen edhe fjalët:

" me mundësi të vazhdimit ".

**III.**

Neni 5, ndryshohet dhe plotësohet duke u riformuluar si në vijim:

"Të drejtë aplikimi për marrjen me qira të banesës së Komuna së Prishtinës, ka individi ose familja me përkujdesje sociale, që dëshmojnë se janë banorë të komunës së Prishtinës së paku 10 vite para kohës së aplikimit"

**IV.**

Neni 6, paragrafi 6.2, në pikën a) pas fjalëve "në periudhën" shtohet formulimi:

"nëse për 6 muaj nuk e paguan qiranë", kurse pika "e" ndryshon si në vazhdim:

"Kur organi kompetent konstaton se nuk është rast social".

## V.

Në nenin 7, pika c riformulohet dhe në të thuhet “të këtë të pazgjidhur çështjen e banimit”, pika e “të jetë në gjendje të rëndë sociale, që dëshmohet me dokumentacion” shlyhet, ndërsa te pika f, emërtimi “Qendra për Asistencë Sociale” zëvendësohen me emërtimin “Qendra për Punë Sociale”.

## VI.

Neni 9 i Rregullores riformulohet si në vijim:

Kriteret për vlerësim me pikë të aplikuesve për ndarjen e banesave për kategorinë me përkujdesje sociale, janë si në vijim:

a). Rast social – përfitues i së drejtës për ndihmë sociale:

- me të ardhura mujore nga 0 - 45.00 € .....6 pikë,
- me të ardhura mujore nga 50.00 – 80.00 € .....5 pikë,
- me të ardhura mujore mbi 80 € .....4 pikë,

b). Numri i anëtarëve të familjes:

- i vetëm.....2 pikë,
- çift bashkëshortor (pa fëmijë) .....2 pikë,
- nëna që ka në përkujdesje familjen .....2 pikë,
- për secilin fëmijë biologjik.....1 pikë,
- për anëtar të familjes me të meta fizike, mentale ose i verbër.....3 pikë,
- për fëmijë jetim –fëmijë që ka nën përkujdesje familja sociale.....2 pikë,
- për anëtar të zhdukur apo të vrarë gjatë luftës.....2 pikë,
- për gjendjen shëndetësore të aplikuesit - provë nga institucioni shëndetësor .....2 pikë,
- për pjesëmarrje në luftë .....3 pikë,
- për invalid të luftës .....4 pikë,
- për familje të dëshmorit .....4 pikë,
- për pensionist.....2 pikë.

c). Familjet që zhvendosen nga ana e Komunës me rastin e ndërtimit të infrastrukturës publike, gëzojnë të drejtën për banesë në shfrytëzim me qira në kohëzgjatje prej 10 vite, me kusht që t’i plotësoj kushtet dhe kriteret e parapara sipas nenit 7 të Rregullores.

## VII.

Në nenin 10, paragrafit 10.1, emërtimi “Qendra për Asistencë Sociale’ zëvendësohet me emërtimi “Qendra për Punë Sociale” kurse formulimi “dhe një përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta”, shlyhet.

### **VIII.**

Në nenin 13, paragrafi 13.1, te pika b, fjalët “banesë apo shtëpi” shlyhen.

### **IX.**

Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, gjen zbatim Ligji nga fusha e banimit, si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushe.

### **X.**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 110 - 44621, më 04.12.2012**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**